



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.201, datë 27.07.2022

PËR
“CAKTIMIN NË DETYRËN E PROKURORIT”

Bazuar në pikën 1 të nenit 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 39 dhe 41 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe në nenin 189, pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë” i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të caktojë **zonjën Matilda Fetau**, në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin.
2. Të njoftohen për këtë vendim zonja Matilda Fetau, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. Ky vendim mund të ankimohet brenda 5 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
5. U shpall në Tiranë, sot më 27.07.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË


KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Eloida Goxhi

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Mirela Bogdani

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Zeqir Hoda